



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:261397
Datë: 12.12.2023
Numri i dokumentit: 05051534

C-IV.-14-6137

Paditësja

V M, nga Beogradi, përfaqësuar nga **Av. S R**, Rr. “Zahir Pajaziti”, pa nr. Prizren.

Kundër

E paditura

N.SH PIK “Progres” Prizren, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP**, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Shkelzen Sylaj gjyqtar kryesues, Sylejman Shumolli dhe Hasim Sogojeva gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 12 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Padia e paditëses konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 29 gusht 2014, paditësja dorëzoi në Dhomën e Posaçme, padi për anulimin e kontratës mbi shitblerjen e patundshmërisë Vr.nr.532/67 e dt. 03 prill 1967, e lidhur në mes të paraardhëses shitëses M nëna e paditëses dhe PIK “Progres” –Prizren, e cila ka të bëjë me parcelën nr. 645/2 në sipërfaqe prej 1,02.10 ha, ZK Dushanovë –Prizren.

Me 16 tetor 2023, gjykata lëshoj një vërejtje me njoftim për pagesën e taksës gjyqësore. Me të njëjtën vërejtje paditësja u informua se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Vërejtja, e lartë cekur, i është dorëzuar përfaqësuesit të paditëses me 18 tetor 2023, dhe gjer me datën e lëshimit të këtij aktvendimi taksa gjyqësore nuk është paguar.

Arsyetimi ligjor

Padia konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 për DHPGJS (Ligji nr. 06/L-086) parasheh: *Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Paditësja konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së *ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.*

Në vazhdim dispozita 253.5 parasheh: *Në qoftë se paditësi/ja nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.*

Me 16 tetor 2023, gjykata përmes vërejtjes kërkoj nga paditësja, që të bëj pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se padia e saj do të konsiderohet e tërhequr nëse ajo nuk e paguan taksën gjyqësore.

Paditëses i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëj pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Paditësja ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të DHPGJS-së në lidhje me udhëzimin e KGJK-së Nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Vërejtja ishte pranuar nga përfaqësuesi i paditëses me 18 tetor 2023, mirëpo ai nuk u përgjigj brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, e as deri me vendosjen e këtij Aktvendimi, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar Kryesues

Sylejman Shumolli, Gjyqtar

Hasim Sogojeva, Gjyqtar